



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3547/Prot.
19

Tiranë më 27.7.2023

VENDIM

Nr. 36, datë 26.07 2023

“Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Analizë dhe Administrim Fiskal”, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38, pika 1 dhe pika 3; në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, gërma a, b dhe c, në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5, gërma “d”, dhe neni 31, gërma “q”; në Vendimin nr.16 datë 28.02.2023 “Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, si dhe në ciklin e tretë të studimeve, Master Ekzekutiv, për vitin akademik 2023- 2024” si dhe në propozimin e Fakultetit të Ekonomisë me shkresën Nr. 1200/1 Prot., datë 26.07.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit, në programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Analizë dhe Administrim Fiskal”, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, për vitin akademik 2023-2024 si më poshtë vijojnë:
 - a. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të parë studimi:
35 kuota
 - b. Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi:
5 Kuota
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha